

PROCESVERBAL
nga seanca e parë publike e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuele
mbajtur më 28.1.2026

Anëtarët e Këshillit të Agjencisë të pranishëm nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr. Sasho Stefanovski, mr. Zirjeta Jajaga, mr. Gordana Majnova, Afrona Vërzivolli, Cvetanka Minovska, Petar Xhurovski, Viktor Pavlovski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë nëpërmjet lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajčevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Të punësuar nga shërbimi profesional të pranishëm nëpërmjet lidhjes video-konferencë: Cvetanka Mitrevska, mr. Emilija Janevska, Maja Damevska, mr. Ruzhica Boshnakoska-Jotevska, dr. Ivana Stojanovska, Goran Sheqerinov.

Të pranishmit e tjerë: /

Kryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski, hapi seancën e parë publike të Këshillit. Seanca filloi në ora 13:30 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

RENDI I DITËS

1. Arsyetim nga SHTR TV M Arnaudov Mihajlo Ohrid ShPKNJ, në lidhje me procedurën për fshirjen nga regjistri i radiodifuzerëve.
2. Të ndryshme.

Kryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski, konstatoi se në seancë nuk kishte të pranishëm përfaqësues nga ShTR TV M Arnaudov Mihajlo Ohrid ShPKNJ, nëpërmjet lidhjes video-konferencë. Duke marrë parasysh se në pajtim me ligjin, seanca është destinuar për arsyetim nga ana e mediumit në lidhje me procedurën për fshirjen nga regjistri i radiodifuzerëve, dhe për shkak të mungesës së përfaqësuesit të tij, kryetari e mbylli seancën.

Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Zëvendëse e kryetarit të Këshillit,
mr. Zirjeta Jajaga